




REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot. Br Prot. <u>01-308/14</u> Prot No.
Nr. I faq Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>28.01.2014</u> Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.01.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4297/13 për znj. *Suzana Manxhuka-Kërliu-Drejtoreshë e Instituteve paraklinike të Fakultetit të mjekësisë në Universitetin e Prishtinës, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-4297-13, për Zyrtaren e lartë, z. Suzana Manxhuka-Kërliu, Drejtoreshë në Institutet paraklinike të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtarja e lartë, znj. Manxhuka-Kërliu së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ajo është paraqitur në AKK, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Manxhuka-Kërliu është deklaruar se njëri biznes është fare jo funksional, por megjithatë shumë shpejt do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuara për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Manxhuka-Kërliu, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë shkresat zyrtare "Informata mbi biznesin" nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) (DPK-03-32-14, dhe DPK-03-141/14) në të cilat shihet se te biznesi privat "Patohistologjia-S" ajo tashmë ka emruar një "person të besuar" për person të autorizuar të biznesit, ndërsa te "Makimport" sh.p.k. znj. Manxhuka-Kërliu është tërhequr krejtësisht nga funksioni i saj

menaxhues, për të ushtruar kështu vetëm funksionin e saj publik si Drejtoreshë e Instituteve paraklinike në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

